



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakt i raportit përfundimtar të revizorit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:** Fakulteti i Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike Shkup

**Lënda e revizionit:**

Revizioni i raporteve financiare për vitin 2019, bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për Llogarinë e Buxhetit Themelor (603)

**Qëllimi i revizionit:**

Të fitohet bindja e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, ndërsa transaksionet dhe aktivitetet e reflektuar janë në pajtim me rregullativën ligjore

**Gjendjet kyçe të konstatuara:**

- regjistrimi i mjeteve dhe i obligimeve nuk është i përgatitur në pajtim me dispozitat ligjore;
- softuerët dhe licencat për shfrytëzimin e softuerëve nuk janë të evidentuar në llogarinë e mjeteve jomateriale dhe
- nuk mbahet evidencë për prokurimin dhe shpenzimin e materialeve të zyrës dhe të tjera.

**Mendimi i dhënë\*:**

Shprehëm mendim me rezervë për realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2019 dhe për harmonizim të aktiviteteve, informacioneve dhe transaksioneve financiare me rregullativën ligjore, udhëzimeve dhe politikave të vendosura.

**Rekomandimet kyçe:**

- Kryerja e regjistrimit në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore me të cilat do të sigurohet pajtueshmëria e kontabilitetit me gjendjen faktike;
- evidentimi i mjeteve jomateriale (softuerëve dhe licencave)
- ndërmarrja e aktiviteteve për vendosjen e evidencës së kontabilitetit të prokurimeve të kryera dhe lëshimin e materialeve.

**Dobësitë sistematike kyçe:**

- formimi i Këshillit Kombëtar për Arsim të Lartë dhe Veprimtari Hulamtuese Shkencore për shkak të ndjekjes së zhvillimit dhe avancimit të cilësisë në arsimin e lartë,
- realizimi i pagave dhe kompensimeve të pagave, në bazë të aktit të brendshëm të institucionit të arsimit të lartë dhe
- miratimi i akteve në nivel të Shërbimit të Universitetit.

**Vërejtjet e marra të Draft-Raportit:**

Në Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror, në afatin e caktuar nga ana e personit përgjegjës të subjektit lëndë e revizionit nuk janë dhënë vërejtje.

**Përgjigjet e vërejtjeve të marra:**

./

\*pozitive me rezervë të pavolitshtëm të përmbajtur